

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“IDEAL SECURITY”**



**Themelues:**

Znj.Shkëndije Lili, atësia Ramiz, lindur më 22.10.1989 në Klos, me vendbanim në Tiranë, Rruga “Sokrat Miho”, P.F. Trade Tirana sh.p.k., Godina 1, Nd. 1, Ap. 1, H Shk 1, Ap. kati 2, Kashar, Mëzez, madhore, zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga letërnjoftimi ID me nr. 036316387 dhe nr. personal 196022003C

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërítë tregtare”, i ndryshuar.

**NENI 1**

**Emri i Shoqërisë**

- 1.1 Emri i shoqërisë është **“IDEAL SECURITY”**.
- 1.2 Forma ligjore e organizimit është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 2**

**Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në Tiranë, në adresën: Njësia Bashkiake nr. 7, Rruga e “Kavajës”, Qendra Concord Center, kati i tretë, Zona Kadastrale 8220.
- 2.2 Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është: [www.IDEALsecurity.al](http://www.IDEALsecurity.al).
- 2.3 Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është: [idealsecurity@.al](mailto:idealsecurity@.al)
- 2.4 Ortaku i Vetëm mund të vendosë për transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter. Organi administruesh i Shoqërisë ka të drejtë të çelë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësiminë Shqipëri dhe jashtë saj.

**NENI 3**

**Kohëzgjatja**

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një **kohëzgjatje të pacaktuar**.

**NENI 4**

**Objekti i Aktivitetit**

- 4.1 Objekti i aktivitetit të shoqërisë, si shoqëri private e sigurimit fizik përfshin:
  - Ruajtjen dhe ofrimin e sigurisë së objekteve me roje private, sisteme kamerash, sisteme alarmi;
  - Shoqërim dhe sigurim personash të njohur (VIP) apo persona të fushës së biznesit, nëpërmjet shërbimeve të truprojave;

**NENI 5**

**Kapitali**

5.1

Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me **100,000 (njëqind mijë) Lekë**, i nënshkruar dhe i ndarë në një kuotë, me vlerë të përgjithshme 100,000 lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit, e zotëruar nga Ortaku i Vetëm Znj. Shkëndije Lili.

## NENI 6

### Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet në çdo moment me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare*”, i ndryshuar. Në çdo rast kapitali i regjistruar nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal të parashikuar nga ligji.

## NENI 7

### Asambleja e Përgjithshme

- 7.1 Në përputhje me nenin 81, pika 3, e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare*”, i ndryshuar, për sa kohë që kapitali i Shoqërisë zotërohet nga një Ortak i Vetëm, të drejtat dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm.
- 7.2 Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Në mënyrë të veçantë, duhet të regjistrohen vendimet e mëposhtme për:
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve ushtrimore;
  - vendimet për investime;
  - riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
- 7.2 Çdo vendim i Ortakut të Vetëm që nuk është regjistruar në regjistrin e vendimeve do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm.
- 7.3 Ortaku i Vetëm vendos për të gjitha çështjet e parashikuara në nenin 81 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare*”, i ndryshuar.
- 7.4 Të gjitha modalitetet e organizimit të vendimmarjes do të zbatohen sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar në fuqi.

## NENI 8

### Administrimi i Shoqërisë

- 8.1 Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm, i zgjedhur nga Ortaku i Vetëm për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetesh. Administratori i Vetëm mund të rizgjidhet ose shkarkohet nga Ortaku i Vetëm. Në kohën e themelimit të kësaj shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, Administratori i i Shoqërisë do të jetë Znj. Shkëndije Lili, me mandat pesëvjeçar nga data e këtij akti.

- 8.2 Administratori i Vetëm gjëzon të drejta të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e administritimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm. Administratori mban përgjegjësi për veprimet e kryera gjatë administritimit të Shoqërisë dhe mund të delegojë të tretë për të kryer veprime dhe akte të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë.
- 8.3 Administratori i Vetëm vepron në respektim të politikave tregtare të përcaktuara nga praktikat profesionale dhe vendimmarrjet e Ortakut të Vetëm. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administritimit të Shoqërisë. Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë.
- 8.4 Ortaku i Vetëm përcakton shpërblimin e organit administrues të Shoqërisë.

### NENI 9

#### Kontrolli Financiar

- 9.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga auditues ligjor, në përputhje me ligjin në fuqi. Ortaku i Vetëm do të emërojë një apo më shumë auditues ligjor në të gjitha ato raste kur emërimi vlerësohet i nevojshëm ose kërkohet nga ligji.

### NENI 10

#### Viti Financiar

- 10.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë të aktivitetit të Shoqërisë, i cili fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbyllet në fund të këtij viti.

### NENI 11

#### Bilanci Vjetor dhe Dividendi

- 11.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit të administritimit dhe të audituesit ligjor (nëse është emëruar) miratohen nga Ortaku i Vetëm.
- 11.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Ortaku i Vetëm brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 11.3 Në përputhje me dispozitat e ligjit, Ortaku i Vetëm vendos mbi shpërndarjen e dividendit në bazë të rezultatit financiar të Shoqërisë.

### NENI 12

#### Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

- 12.1 Dispozitat e ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare do të zbatohen në rast prishjeje dhe likuidimi të Shoqërisë.

### NENI 13

#### Legjislacioni i Zbatueshëm

13.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statutin, si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi. Dispozitat e ligjit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare do të zbatohen në rastet e paparashikuara nga ky akt.

**NENI 14  
TË NDRYSHME**

14.1 Ky Akt Themelimi hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje, me vlerë të njëjtë juridike.

*ORTAKU I VETËM THEMELUES  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“IDEAL SECURITY”*

*Ishkendy Sili*  
*Olli*



**STATUTI I**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“IDEAL SECURITY”**

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

**Kreu I**

**Neni 1**

**Themelimi, Emri, Selia Kohëzgjatja,**

1. Emri i shoqërisë është “IDEAL SECURITY”.
2. Forma ligjore e organizimit është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
3. Selia e Shoqërisë është në Tiranë, në adresën: Njësia Bashkiake nr. 7, Rruga e “Kavajës”, Qendra Concord Center, katë i tretë, Zona Kadastrale 8220.
4. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.

**Neni 2**

**Themeluesi**

1. Data e themelimit të shoqërisë është 19.03.2021.
2. Themeluesi i shoqërisë është **Znj. Shkëndije Lili**, atësia Ramiz, lindur më 22.10.1989 në Klos, me vendbanim në Tiranë, Rruga “Sokrat Miho”, P.F. Trade Tirana sh.p.k., Godina 1, Nd. 1, Ap. 1, H Shk 1, Ap. kat 2, Kashar, Mëzez, madhore, zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga letërnjoftimi ID me nr. 036316387 dhe nr. personal **I96022003C**.

**Neni 3**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Ruajtjen dhe ofrimin e sigurisë së objekteve me roje private, sisteme kamerash, sisteme alarmi;
- Shoqërim dhe sigurim personash të njohur (VIP) apo persona të fushës së biznesit, nëpërmjet shërbimeve të truprojave;

**Kreu II**

**Kapitali**

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 Lekë (\**sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë*\*). Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tij të mëposhtëm:
  - Ortaku themelues Znj. **Shkëndije Lili** është Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme, 100,000 lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## Neni 6

### Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

1. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
2. Zvogelimi i kapitalit ndërmerrret nëpërmjet vendimit të Ortakut të Vetëm dhe nuk mund të prekë minumin ligjor.

## Neni 7

### Transferimi i kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme, për sa kohë nuk parashikohet ndrysne në ligj.
3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU III

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

## Neni 8

### Organi Vendimmarrës

1. Në përputhje me nenin 81, pika 3, e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, për sa kohë që kapitali i Shoqërisë zotërohet nga një Ortak i Vetëm, të drejtat dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm.
2. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Në mënyrë të veçantë, duhet të regjistrohen vendimet e mëposhtme për:
  - miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - shpërndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve ushtrimore;
  - vendimet për investime;
  - riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
3. Çdo vendim i Ortakut të Vetëm që nuk është regjistruar në regjistrin e vendimeve do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm.
4. Ortaku i Vetëm vendos për të gjitha çështjet e parashikuara në nenin 81 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
5. Të gjitha modalitetet e organizimit të vendimmarrjes do të zbatohen sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 9**  
**Administrimi**

1. Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm, i zgjedhur nga Ortaku i Vetëm për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori i Vetëm mund të rizgjidhet ose shkarkohet nga Ortaku i Vetëm. Në kohën e themelimit të kësaj shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, Administratori i Shoqërisë do të jetë Znj. Shkëndije Lili, me mandat pesëvjeçar nga data e këtij akti.
2. Administratori i Vetëm gjëzon të drejta të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm. Administratori mban përgjegjësi për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të delegojë të tretë për të kryer veprime dhe akte të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë.
3. Administratori i Vetëm vepron në respektim të politikave tregtare të përcaktuara nga praktikat profesionale dhe vendimmarrjet e Ortakut të Vetëm. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë. Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë.
4. Ortaku i Vetëm përcakton shpërblimin e organit administrues të Shoqërisë.
5. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
6. Personin i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë të shoqërisë me mandat 5 –vjecar, me të drejtë rizzgjedhjeje, si dhe të drejtën përlargimin përfundimit të mandatit, me kusht pritjeje deri në emërimin e administratorit të ri.

Të dhënat e identifikimit:

**Shkëndije Lili**

dhe specimenët e nënshkrimit:

**Neni 10**

**Kompetencat e Administratorëve**

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetem;
  - b) përfaqësojnë shoqerinë tregtare;
  - c) kujdesen përmbiqjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve
  - d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
  - e) raportojnë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

- Nëse emërohet më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- Ortaku i vetëm mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 11

### Pergjegjesite e Administratorit

- Administratori eshte përgjegjës individualist, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- Pasojet e marrëveshjeve të pamiratuara që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojet përkatëse.
- Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:
  - të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.

## Neni 12

### Drejtimi Teknik

- Drejtuesi Teknik i shoqërisë do të jetë **Z. Hasan Basha**, lindur më 18.07.1963 në Novosej, me vendbanim në Tiranë, pajisur me letërnjoftimin Id me nr. 034240899 dhe nr. personal G30718051C.
- Afat i emëritit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

## Kreu IV

Viti finanziar-ekspertet

**Neni 13**  
**Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

**Neni 14**  
**Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithe vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtë vendimore qe ka.

**Kreu V**  
**Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

**Neni 15**  
**Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të Ortakut te Vetem;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";  
d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 16**  
**Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednit të Ortakut te Vetem, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 17**  
**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 18**  
**Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.


**Nenit 19**  
**Logo e shoqërisë**

Logo e shoqërisë përmban stemën që identifikon shoqërinë dhe gjendet bashkëlidhut këtij statuti.

*Ortaku i Vetëm*  
**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**IDEAL SECURITY**

*Ishenadje Sili*  
*Xh. Xh.*



✓

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE TIRANË**  
**NOTER MIRANDA F. XHEMALÇE**



V2021053270071392119

DATE 19/03/2021

NR REP 881

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Në Tiranë sot, më datë 19.03.2021, para meje Notere MIRANDA F. XHEMALÇE, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Bulevardi "Zhan D'Ark", Pallati 21/1, Shkalla 1, Apartamenti 1, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUJESE:**

Shkëndije Lili, atësia Ramiz, amësia Vere, shtetas Shqiptar, lindur në Klos, Burrel dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.'sokrat Miho', P.F.Trade Tirana Sh.P.K., God.1; Nd. Ap.1; H. Shk.1; Ap. Kati2; Kashar; Mézez; 1050; Tiranë, lindur më 22/10/1989, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036316378 dhe nr. personal I96022003C.

Subjekti i mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres, "Akt Themelimin dhe Statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " IDEAL SECURITY", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gëрма "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë , vërtetoj nënshkrimin e saj te hedhur në këtë Akt themelim dhe Statut.

*Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.*

**NOTER**

MIRANDA F. XHEMALÇE

NOTE RE

MIRANDA XHEMALÇE  
TIRANË - ALBANIA